



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2020
Nr. Dok. 202000835/2

Lënda: *Rekomandohet analizimi i situatës në të cilën ndodhet procesi i ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe marrja e masave administrative që kjo situatë të mos përsëritet më në të ardhmen.*

Rekomandohet vijimi i kryerjes së veprimeve përbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Drejtuar: **Z. Piro Lutaj**
Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor Shtetëror
Adresa: Rruga e "Kavajës"

Z. Marsel Himallari

TIRANË
Përbarues Gjyqësor
Pranë: Zyrës së Përbarimit

DURRËS

I nderuar z. Lutaj!

I nderuar z.Himallari!

Institucioni i Avokatit të Popullit më datë 03.07.2019, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit H.Zh, në të cilën është prezantuar shqetësimi për mosekzekutimin nga ana e Zyrës së Përbarimit Durrës, të Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilin po kjo Gjykatë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr.2137U, datë 21.12.2017, me objekt:

"Detyrimin e të paditurit V.S.të lirojë rrugën e zënë për në banesën e paditësit H.Zh, duke shembur murin e avëllisë dhe ndërtimin që ka bërë, aq sa distanca nga buza e kanalit deri në ndërtimin e bërë nga i padituri V.S., të jetë 4 metra.

Detyrimin e të paditurit B.S.të lirojë rrugën e zënë për në banesën e paditësit H.Zh, duke shembur gardhin me tela, derën e hekurit dhe ndërtimin e bërë mbi rrugën e kalimit aq sa distanca nga buza e kanalit deri në ndërtimin e bërë nga i padituri B.S.të jëtë 4 metra.

Detyrimin e të paditurit Z.ZH.të prishë murin e avëllisë të ndërtuar në rrugën e kalimit që ka ekzistuar më parë sipas plan-rilevinmit të marrë nga ZVRPP Durrës. Detyrohen të paditurit R.S., A.S. të pushojnë cënimin që i bëjnë paditësit H.Zh në banesën ekzistuese dhe në truallin e tij, sipas çertifikatës së pronësisë së paditësit e knonkretisht të mos kryejne veprime të tilla si heqje tjegullash nga çatia e shtëpisë së tyre ngjitur me banesën e H.Zh , veprime të cilat dëmtojnë banesën në pronësi të paditësit H.Zh dhe të mos përsërisin atë në të ardhmen”.

Për vënien në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit, ankuesi, i është drejtuar Zyrës së Përmbarrimit Durrës, me kërkesën datë 01.08.2018, e cila është administruar me nr.6466 të rregjistrimit, prej Zyrës së Përmbarrimit Durrës.

Me rastin e pranimit të kërkesës së gjyqfituesit, z.ZH, për vënien në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit, ju z.Përmbarrues, keni lajmëruar me shkresën nr.05/6466, datë 02.08.2018, palën gjyqëbjerrëse, për detyrimet e vendosura ndaj secilit prej tyre, duke caktuar me këtë rast dhe afatin ligjor prej dhjetë ditësh për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të detyrimeve. Në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve në mënyrë vullnetare, ju informoni me shkresën nr.104/1 Prot, datë 10.07.2019, Avokatin e Popullit, se keni kryer më datë 13.09.2018, veprime përmbarrimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Konkretisht, në proces verbalin e mbajtur në këtë datë, ju shpreheni, se:

“... në prani të palëve kreditor/debitor... është prishur gardhi me tela për të krijuar rrugën e kalimit më gjerësi 4m, heqjen e derës së hekurit si dhe ndarjen e kufirit duke caktuar distancën nga themeli i pronës së kreditorit deri në murin e vjetër ekzistues që është në bashkëpronësi, duke marrë pala kreditore prishjen e këtij muri dhe ndërtimin e murit të ri me shpenzimet e veta.

Lidhur me pikën tjetër për prishjen e ndërtimit, me shkresën nr.05/6466 Prot, datë 14.09.2018, përmbarruesi gjyqësor i është drejtuar palës kreditore duke e orjentuar atë t'i drejtohet gjykatës për sqarim dhe interpretim të vendimit pasi “Sipas aktit të ekspertimit të ekspertit topogjodet z.Edmond Bici, i caktuar nga gjykata, rezulton se: “Çertifikata e pronësisë (HTR përkatëse) dhe gjendja faktike në vend e pasqyruar në skicën hartografike nr.1. Plan rilevimi figuron që të ketë mospërputhje midis dy pozicioneve, kjo mospërputhje vjen si rezultat i gabimeve që ekzistojnë në HTR e ZVRPP Durrës. Për të bërë verifikimin nëse prona e paditësit cënohet nga posedues të tjerë apo jo, është e domosdoshme të bëhet më parë korrigjimi i HTR nga ZVRPP Durrës, për të rregulluar gabimin që ekziston në mospërputhjen e gjendjes faktike me paraqitjen e saj në HTR. Në lidhje me vijimin e mëtejshëm të ekzekutimit të këtij titulli ekzekutiv, në mënyrë të përsëritur i është kërkuar palës kreditore z.H.Zh, t'i drejtohet gjykatës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të mësipërm, fakt ky i vërtetuar edhe me proces verbalin e datës 31.10.2018, që vetë pala kreditore në pretendimet e tij ka deklaruar se është dakort t'i drejtohet gjykatës për sqarimin e vendimit në lidhje me mospërputhjen e pozicioneve.

Me shkresën nr.05/6466, datë 13.02.2019, përmbarruesi gjyqësor ka marrë Vendimin “Për pezullimin e urdhërit të ekzekutimit”, bazuar në nenin 615, germa “dh” të K.Pr.C., që parashikon, se: ... dh) “Kur kreditori nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbarruesi gjyqësor”. Pala kreditore ka marrë dijëni për

vendimin e pezullimit, vërtetuar me letërporosinë me mbishkrimin (refuzuar) nga vetë pala kreditore.

Zyra e Përmbarrimit Durrës, do të vijojë me procedurën për ekzekutimin tërësisht të vendimit gjyësor, vetëm pasi të kryhet sqarimi dhe interpretimi nga gjykata lidhur me pozicionimin e pronës”.

Përpos informacionit dhe shpjegimeve të dhëna, pala kreditore, më datë 06.08.2019, ka deklaruar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, se, ekzekutimi i Vendimit Gjyësor civil të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, i dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyësor Durrës, nuk është kryer dhe pse vendimi gjyësor civil është i qartë dhe i saktë.

Qëndrimin e Zyrës së Përmbarrimit Durrës, tuaj, në kryerjen e veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv në fjalë, nuk e gjejmë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, objektivitetit, si dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, sikurse parashikuar në nenin 4 të ligjit nr.8730, datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyësor”*, të ndryshuar.

Në ndryshim nga justifikimi i dhënë prej jush në shkresën nr.104/1 Prot, datë 10.07.2019, drejtuar Avokatit të Popullit, konstatohet se, Vendimi nr.05/6466 Prot, datë 13.02.2019, *“Për pezullimin e Urdhërit të Ekzekutimit”* është marrë në referim të parashikimit të kryer në nenin 615/dh të Kodit të Procedurës Civile apo ligjin nr.8730, datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyësor”*, të ndryshuar. Në këtë nen parashikohet, se:

“Ekzekutimi pezullohet: dh) kur kreditori nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbarruesi gjyësor”.

Ndërsa ligji nr. 8730, datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyësor”*, të ndryshuar, në asnjë dispozitë të tij nuk parashikon kryerjen e procedurës sikurse mbajtur prej jush z.H.. Pra, ekziston kontradiktë midis justifikimit të dhënë Avokatit të Popullit në shkresën nr.104/1 Prot, datë 10.07.2019, për pezullimin e ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit dhe bazës ligjore në të cilën mbështesni marrjen e Vendimit nr.05/6466 prot, datë 13.02.2019. Në pjesën përshkuese të këtij vendimi, nuk përmenden rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë ekzekutimit, si dhe provat dhe arsyet mbi të cilat mbështet vendimi i pezullimit.

Në shpjegimet tuaja, drejtuar Avokatit të Popullit, nuk e përmendin si shkak mosparaqitjen e kreditorit (gjyqfituesit), në afatin e parashikuar në nenin 615/dh, pranë kësaj Zyre, për justifikimin e marrjes së Vendimit nr.05/6466 prot, datë 13.02.2019. Po kështu, nga aktet e vëna në dispozicion Avokatit të Popullit, nuk vërtetohet kryerja e procedurës sikurse parashikuar në nenin 615/dh të K.Pr.C., fakt i cili, provon, se ju, keni zhvilluar dhe zhvilloni veprimtarinë përmbarrimore në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv të lartpërmendur, në kundërshtim me parimet e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr.8730, datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyësor”*, të ndryshuar.

Në kushtet kur vendimi i pezullimit të titullit ekzekutiv të lartpërmendur, ka referencë ligjore si më sipër, lind pyetja: Përse ju në shkresën nr.104/1 Prot, datë 10.07.2019, drejtuar Avokatit të Popullit, justifikoni Vendimmarrjen nr.05/6466, datë 13.02.2019, në referim të aktit të ekspertimit të kryer prej ekspertit të thirrur nga Gjykata e Rrethit Gjyësor Durrës, në këtë proces? Ky qëndrim juaj është një tjetër provë e mungesës së aftësive profesionale, jo vetëm për faktin se nuk është referuar si shkak për pezullimin e ekzekutimit, por për më tepër, akti i

ekspertimit është vlerësuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me rastin e dhënies së Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, dhe është pjesë përbërëse e tij. Në kundërshtim me shkakun ligjor mbi të cilin është mbështetur vendimi nr.05/6466 Prot, datë 13.02.2019, *“Për pezullimin e Urdhërit të Ekzekutimit”*, ju z.Përmbarues, kushtëzoni vijimin e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duke i bërë të ditur palës kreditopre (gjyqfituese) se duhet të kërkojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, sqarimin dhe interpretimin e Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017. Ky qëndrim juaj nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë të akteve ligjore dhe nënligjore që parashikojnë ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv.

Referuar objektit të veprimtarisë, sikurse parashikuar në nenin 3 të ligjit nr.8730, datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, përmbaruesi gjyqës ka tagër ligjor të kryejë ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rastet e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile. Për rrjedhojë, çdo veprim përmbarimor i kryer jo në përputhje me parashikimet e ligjit në fjalë, përbën shkak si për fillimin e procedurës disiplinore ashtu dhe marrjen në përgjegjësi penale për kryerjen e veprës penale, *“Mosekzekuim pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës”*, parashikuar i dënueshëm në nenin 320/a të Kodit Penal.

Përcaktimi i nenit 606, të K.Pr.C. detyron Zyrën e Përmbarimit Durrës, të kryejë ushtrimin e detyrës për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv nr.2137, datë 21.12.2017, si dhe vendosjen e sanksioneve ligjore ndaj personave të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës janë të detyruar të kryejnë.

Mosrespektimi i së drejtës të ankuesve brenda afatit ligjor, neglizhenca, mungesa e predispozicionit, mosimpinjimit dhe vlerësimit si duhet të këtij problem të mprehtë social dhe ekonomik, nuk i shërben rritjes dhe përmirësimit të standardeve të shtetit ligjor, ndikon në mosfinalizimin e procesit të dhënies së drejtësisë, dhe sikundër kuptohet edhe nga ankesa e mësipërme, ul autoritetin e insitucionit tuaj dhe krijon premisë për humbjen e besimit ndaj dhënies së drejtësisë, duke cënuër të drejtat dhe liritë e shtetasve të mbrojtura nga Kushtetuta dhe Ligjet. Një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike është detyrimi i autoriteteve publike për vënien në zbatim të urdhërimeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar.

Duke e vlerësuar të parregullt veprimtarinë e Zyrës së Përmbarimit Durrës, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të lartpërmendur në afatin ligjor apo afat të arsyeshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të parashikimit të kryer në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, së: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrate publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen masash për vënien në vend të të drejtës së shkelur tek organi administrative që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDON

Analizimin e situatës si dhe marrjen e masave administrative që kjo situatë të mos përsëritet më në të ardhmen.

Vijimin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të shkrësës nr.104/1 Prot, datë 10.07.2019, të Zyrës së Përmbarimit Durrës, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të Vendimit nr.05/6466 Prot, datë 13.02.2019, “Për pezullimin e Urdhërit të Ekzekutimit”, të Zyrës së Përmbarimit Durrës.

Kopje të vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.2137, datë 21.12.2017, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, (faqja e parë dhe e fundit)

Me besim në bashkëpunimin tuaj!

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA(CANAJ)